



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 638/5 Prot.

Tiranë, më 16.11.2020

V E N D I M

Nr.149, datë 16.11.2020

“Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit për transferimin e përkohshëm të punonjësit **, si pasojë e ristrukturimit të institucionit Bashkia Memaliaj”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 638 prot., datë 17.07.2020, për disa pretendime për paligjshmëri, të ngritura nga ***** në lidhje me procedurën e transferimit të përkohshëm për shkak të ristrukturimit të institucionit, Bashkia Memaliaj,

VËREJ SE:

Punonjësi ***** nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 638 prot., datë 17.07.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit administrativ të transferimit të përkohshëm, për shkak të ristrukturimit të institucionit Bashkia Memaliaj.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ të çështjes, ka rezultuar e vërtetuar se, nëpunësi ***** pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, është emëruar në pozicionin e punës “Specialist Asetesh”, në Bashkinë Memaliaj, me aktin

e datës 09.08.2017, “Nëpunës civil në periudhë prove”, të njësisë së burimeve njerëzore ku pas plotësimit të kërkesave ligjore, ka përfituar statusin e nëpunësit civil me aktin nr. 1554 prot., datë 21.11.2019 “Nëpunës civil i konfirmuar”.

Ndërkohë, institucioni Bashkia Memaliaj, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 83, datë 26.12.2019, konfirmuar nga Perfekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresën nr. 2/1 prot., datë 16.01.2020, ka kaluar në proces ristrukturimi i cili ndër të tjera, ka sjellë ndryshim të kërkesave të posaçme për pozicionin e punës “*Specialist Asetesh*”, duke ndryshuar edhe emërtimin në “*Specialist Buxheti dhe Asetesh*”.

Nisur nga sa më sipër, me vendimin nr. 126, datë 02.03.2020, “*Lirim dhe emërim në punë*”, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, ka liruar nga detyra ankuesin *****, nga pozicioni i punës “*Specialist Asetesh*” dhe e ka emëruar atë në pozicionin e punës “*Specialist i Urbanistikës*”, në Bashkinë Memaliaj.

Nga ana e Bashkisë Memaliaj, nëpërmjet dokumentacionit të vënë në dispozicion pretendohet se, ky transferim i ankuesit është bërë në kuadër të ristrukturimit të institucionit, vendim i cili është pranuar edhe prej nëpunësit.

Por më pas, nga ana e njësisë përgjegjëse, është konstatuar se emërimi i nëpunësit ***** në pozicionin “*Specialist i Urbanistikës*” ishte i paligjshëm për shkak se ai nuk plotësonte kërkesën e arsimit për këtë pozicion pune. Për pozicionin në fjalë kërkohet që të kesh diplomë në fushën e ndërtimit ose urbanistikës, kurse nëpunësi ***** është i diplomuar në fushën e ekonomisë.

Kjo mospërputhje është rregulluar më pas me aktin nr. 1252/6 dt. 23.10.2020 të Njesisë Përgjegjëse, e cila ka kryer emërimin e nëpunësit në fjalë në pozicionin “*Specialist Tatim Taksash*”, në Bashkinë Memaliaj, emërim i cili është pranuar nga nëpunësi dhe konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj.

Në këtë mënyrë, është zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshja e krijuar në këtë rast, gjë që do të thotë se menaxhimi i këtij rasti është përmbyllur në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Nga sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se veprimi fundit i kryer nga njësia përgjegjëse, për transferimin e përhershëm të nëpunësit ***** në pozicionin “*Specialist Tatim Taksash*” në Bashkinë Memaliaj, vlerësohet i kryer në përputhje me ligjin, për këtë arsye, meqënëse mosmarrëveshja ka gjetur zgjidhje të rregullt, bazuar në nenin 16, pika 6, të Kreut III, “*Procedura paraprake*”, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, kërkesa e nëpunësit ***** duhet të arkivohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të ankesës nr. 638 prot., datë 17.07.2020, të punonjësit *****, në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera apo lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit administrativ të transferimit të tij për shkak të ristrukturimit të Bashkisë Memaliaj dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Memaliaj, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Memaliaj dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha